



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PEJË

---

AD/GJTHPE/.nr.7/23

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit SH.H, gjyqtarit M.K dhe gjyqtares P.B, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga S.K, rruga “N. K.”, nr., fshati GJ., Komuna I., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 18.08.2023, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e parashtruar nga S.K, nga fshati GJ., Komuna I., ndaj gjyqtarit SH.H, gjyqtarit M.K dhe gjyqtares P.B, **SI E PABAZUAR**.

### A r s y e t i m

Me datë 28.07.2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka transmetuar te autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Pejë parashtruesin e pranuar nga Ministria e Drejtësisë - Kabineti i Ministres së Drejtësisë lidhur me ankesën disiplinore të parashtruar nga S.K, rruga “N. K.”, nr., fshati GJ., Komuna I., ndaj gjyqtarit SH.H, gjyqtarit M.K dhe gjyqtares P.B lidhur me lëndën juridiko – civile kontestimore C.nr.390/19, të paditësit B.K, nga fshati GJ., Komuna K., ndërhyrësit kryesor S.K njëherit i autorizuar i vëllezërve K.dhe S.K dhe personalisht vëllai Z.K, kundër të paditurve Z.K, B.K, E. dhe H.E, e gjinisë K. si dhe B.G, e përfaqësuar nga djali i saj B.G, duke theksuar se të paditurit ende pa e ndarë trashëgiminë e pronës nga pronari legjitim i cili ka vdekur me datë 01.02.1994, lidhin kontratë false dhe mashtruese të shitblerjes me datë 07.05.2018, duke mos respektuar fare të drejtën e parablerjes së këtu parashtruesit të ankesës disiplinore dhe vëllezërve të tij të cilët kanë qenë të interesuar për t’a blerë atë tokë, për këtë arsye paditësi B.K, në vitin 2019 ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në I. dhe që nga ajo kohë pala e cila e ka shitur tokën edhe pse kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata, nuk janë paraqitë asnjëherë në seancë dhe lënda që 4-5 vite është në pikën 0, për këtë arsye ndjehen të zhgënjyer nga gjykata për mënyrën e shqyrtimit të kësaj lënde, duke theksuar se janë lodhur duke shkuar në seanca të cilat përfundojnë vetëm me konstatime se kush merr pjesë në seancë e kush jo, ndërsa situata në terren nuk është e mirë. Lidhur me këtë çështje, parashtruesi i ankesës ka theksuar se ka kërkuar takim me gjyqtarin SH.H – Gjyqtar Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog. dhe nga i njëjti ka kërkuar sqarim për stërzgjatjen e kësaj procedure nga viti 2019 deri në vitin 2023 dhe ndërrimin e 3-4 gjyqtarëve por, i njëjti e mori si normale, nuk e shqetësuan brengat e tyre dhe i njëjti ia ka urdhëruar që t’ia lirojnë zyrën . Në raport me gjyqtarin M.K, këtu parashtruesi i ankesës ka theksuar se i njëjti duke vepruar sipas kërkesës së të autorizuarit të paditësit ka caktuar masën e përkohshme të sigurisë ndërsa, lidhur me gjyqtaren P.B, ka theksuar se e njëjta e ka shtyrë seancën e datës 25.05.2023 për shkak të mospjesëmarrjes së palëve kurse në seancën e datës 30.06.2023, e ka obliguar këtu parashtruesin e ankesës që brenda afatit prej 3 ditësh të dorëzoj autorizimin e ri për përfaqësim të dy vëllezërve të tij që jetojnë jashtë shtetit. Bashkëngjitur ankesës disiplinore si provë ka dorëzuar Kontratën Private mbi Shitjen e Patundshmërisë, e lidhur me datë 07.05.2018 dhe një Përgjigje në parashtrësë, drejtuar gjyqtarit B.I, me datë 10.11.2022.

Me datë 02.08.2023, konform nenit 9 par.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të njëjtën ankesë disiplinore të parashtruar nga ankuesi S.K ndaj gjyqtarit SH.H, gjyqtarit M.K dhe gjyqtares P.B, Gjykata Supreme e Kosovës e ka përcjellë në kompetencë të autoritetit kompetent të Gjykatës Themelore në Pejë.

Me datë 31.07.2023, në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është njoftuar për ankesën disiplinore të parashtruar ndaj gjyqtarit SH.H, gjyqtarit M.K dhe gjyqtares P.B.

Gjyqtari SH.H, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka theksuar se në lëndën C.nr.390/19, paditësit kanë parashtruar padi me bazë juridike vërtetim pronësie me propozim për caktim të masës së përkohshme, e cila lëndë i është ndarë në punë, por meqë palët ndërgjyqëse janë vëllezërit dhe vjehrra e djalit të axhës, mbi bazën e kësaj rrethane ka kërkuar përjashtimin e tij nga kjo lëndë, e cila kërkesë i është aprovuar dhe lënda i është ndarë në punë gjyqtarit M.K. Pasi gjyqtari M.K nga dega në I. është caktuar që të punoj në Gjykatën Themelore në Pejë – selia, lënda i është ndarë në punë gjyqtarit B.I, i cili më pas është transferuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë andaj, lënda i është ndarë në punë gjyqtares P.B ngase në degën në I. nuk ka gjyqtarë të tjerë në Divizionin Civil. I njëjti po ashtu, ka theksuar se si Gjyqtar Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në I., për hirë të transparencës dhe informimit të saktë të qytetarëve, çdo javë – ditën e enjte e ka caktuar si ditë takimi me qytetarë dhe se këtu parashtruesin e ankesës e ka pranuar me datë 06.07.2023, i cili ka ngritë shqetësimin se lënda e tij po zvarritet qëllimisht dhe të njëjtin e ka njoftuar me arsyet e mos trajtimit të kësaj lënde përkatësisht, arsyet e përjashtimit të tij si gjyqtar dhe ndërrimi i gjyqtarëve të tjerë si dhe e ka njoftuar se nuk ka të drejtë të bisedoj për çështjen kryesore ngase për këtë është kompetente gjyqtarja e ngarkuar me lëndë dhe se komentimi eventual mund të paraqes shkelje disiplinore nga ana e tij, por edhe përkundër sqarimeve të dhëna për mbi 10 minuta, i njëjti ka filluar ta ngrit zërin duke iu drejtuar me fjalët se “qëllimisht është duke u zvarritë kjo procedure, çfarë gjykate është kjo, çfarë gjyqtareve ke, që 4 vite nuk është caktuar kjo lëndë”, pas kësaj gjyqtari ka deklaruar se i është drejtuar me këto fjalë “zotëri unë ju shpjegova arsyen e mos trajtimit të lëndës C.nr.390/19, por nëse mendon se me zhurmë dhe britma mund të kryhet e keni gabim”, ngase kjo lëndë kryhet sipas agjendës së planifikimit përkatësisht, sipas strategjisë së KGJK-së. Përfundimisht, gjyqtari ka shtuar se komunikimi me të njëjtin si me gjithë të tjerët, ka qenë tejet korrekt në kuptimin e dhënieve të arsyeve pse nuk është trajtuar deri më tani lënda.

Gjyqtari M.K, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka theksuar se pas leximit dhe shqyrtimit të ankesës vlerëson se e njëjta fillimisht, në vetë përmbajtje është e paqarët, nuk dihet se çka kërkohet me te njëjtën, nga vete referati i saj nënkupton se Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Istog. e ka trajtuar këtë lëndë dhe janë marr veprime për trajtimin e saj ndërsa, pretendimet e tjera në këtë parashtruese nuk janë argumentuar me asnjë provë, por vetëm është dhënë një përshkrim i paargumentuar dhe provuar dhe se të gjitha veprimet që janë ndërmarr nga ana e tyre si gjyqtar në këtë lëndë gjinden në shkresat e lëndës me numër C.nr. 390/19, në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Istog. Andaj, konsideron se ankesa në fjalë nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë të Ligjit Nr. 06/L- 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjyqtarja P.B, në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka theksuar se pasi ka filluar pjesën praktike të trajnimit fillestar për gjyqtar, me qëllim që lëndët më të vjetra se viti 2020 të trajtohen në afat të arsyeshëm kohor, ka filluar me procedimin e lëndëve, në mesin e të cilëve edhe lënda C.nr. 390/19, në të cilën lëndë qytetari S.K, së bashku me vëllezërit e tij

K.K., Z.K dhe S.K, me datë 08.12.2020 kishin parashtruar kërkesë që gjykata përgjatë shqyrtimeve të ardhshme gjyqësore, t'i ftoj në cilësinë e ndërhyrësve kryesor. Lidhur me këtë, seanca e shqyrtimit përgatitor është caktuar me datën 25.05.2023, për të cilën seancë, nuk janë plotësuar kushtet për mbajtjen e së njëjtës, ngase për dy nga palët e paditura, flete kthesa është kthyer me mbishkrimin “përpyekjet për dorëzim janë bërë disa herë, adresa është e panjohur” dhe pas verifikimit nga ana e gjykatës, ka rezultuar se në ftesa është shkruar vetëm komuna nga vijnë palët dhe jo edhe emri dhe numri i rrugës, për çka gjykata ka vlerësuar se të paditurat nuk janë ftuar në mënyrë të rregullt. Në seancën e shqyrtimit përgatitor të datës 29.06.2023, për të njëjtat të paditura fletë kthesa është kthyer me mbishkrimin “përpyekjet janë bërë për dorëzim, marrësi refuzon pranimin”, për çka gjykata ka vlerësuar se përsëri nuk janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës, duke qenë se dorëzimi i ftesave, nuk është bërë konform nenit 112 të LPK, në të cilin përcaktohet se *“Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t’ia lejë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t’ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm”*, për çka në rastin konkret, ftesa është kthyer në gjykatë dhe nuk iu është lënë në vendbanimin e të paditurave, siç e përcakton dispozita e lartcekur. Seanca e radhës në këtë çështje është caktuar me datë 19.09.2023 meqenëse, gjyqtarja e çështjes në muajin korrik, me ç’rast me rastin e dorëzimit të ftesave palëve, duke bërë përpyekje maksimale që të plotësohen kushtet për mbajtjen e seancës, respektivisht dorëzimi i rregullt i ftesave të palëve ndërgjyqësore, iu ka drejtuar me parashtrësë edhe shpërndarësit të postës në K., duke e njoftuar për mënyrën e dorëzimit të ftesave/shkresave në rastet kur marrësi refuzon pranimin e shkresës. Sa i përket pretendimit ankimor, se gjykata ka kërkuar autorizim të ri për përfaqësim, gjykata pasi ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ekzistonte asnjë autorizim për përfaqësim të vëllezërve të tij nga ndërhyrësi S.K, e po ashtu nuk ekzistonte autorizim as për përfaqësimin e të paditurës B.G, nga djali i saj B.G por në seancën e datës 12.10.2022, është marrë vetëm aktvendim me të cilin është aprovuar propozimi i ndërhyrësve, të cilët kanë shprehë dëshirë që në këtë çështje t’i përfaqësoj S.K, si dhe të paditurën Bardhë që ta përfaqësoj djali i saj, gjykata duke vlerësuar se autorizimi nuk është dhënë në formë as të shkruar e as gojarisht në procesverbal nga gjykata, konform nenit 92 të LPK-së në të cilin përcaktohet se *“92.1 Pala e jep autorizimin për përfaqësim në formë të shkruar ose gojarisht në procesverbal tek gjykata. 92.2 Pala që nuk di shkrim /lexim ose që nuk është në gjendje të nënshkruhet do të vejë në prokurën e shkruar, shenjën e gishtit tregues. Në qoftë se në këtë rast prokura i jepet personit që nuk është avokat, nevojitet prania e dy dëshmitarëve, të cilët do të nënshkruhen në prokurë. 92.3 Po që se dyshohet në vërtetësinë e prokurës, gjykata mund të vendosë me aktvendim që të paraqitet prokura e verifikuar. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi”*. Andaj meqenëse në seancën e datës 12.10.2022, nuk kishte dhënie të autorizimeve, të cilat duhet të jenë edhe të nënshkruara nga dhënësit e autorizimit, gjykata të njëjtit i detyroi që brenda afatit prej 3 ditësh, nga dita e pranimin të aktvendimit, t’i dorëzojnë autorizimet për përfaqësim, duke i njoftuar palët se do të pajisen edhe me aktvendim të veçantë dhe se afati prej 3 ditësh fillon të rrjedh nga dita vijuese, pasi të pranohet aktvendimi i veçantë. Aktvendimin e veçantë, palët e kanë pranuar me datë 19.07.2023 andaj, nga data 30.06.2023 kur palët veç janë njoftuar për sigurimet e autorizimeve e deri me datën 19.07.2023, kur të njëjtit e kanë pranuar aktvendimin e veçantë, kanë kaluar më shumë se 20 ditë. Pas përfundimit të seancës së datës 30.06.2023, duke prit për nënshkrimin e procesverbalit, ndërhyrësi S.K, i revoltuar se pse po shtyhet seanca gjyqësore dhe pse po detyrohet të sjell autorizimin për përfaqësim, i është drejtuar gjyqtarës së çështjes me fjalët se *“a e ke gabim ti apo gjyqtari i mëparshëm”*, për çka gjyqtarja ia ka tërheqë vërejtjen, që të mos komentoj.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar si dhe deklaratat e gjyqtarëve ka gjetur se ankesa disiplinore e parashtruar gjyqtarit SH.H, gjyqtarit M.K dhe gjyqtarës P.B, është e pabazuar.

Në këtë procedurë, autoriteti kompetent nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të ankesës se si është nënshkruar kontrata lidhur me pronën objekt kontesti të padisë, pretendimet se kontrata në fjalë është false dhe mashtruese apo se prona në fjalë është shitë nga pronarët jolegjitim, meqë pretendimet e tilla duhet të vërtetohen në procedura gjyqësore dhe të njëjtat nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore të gjyqtarëve.

Autoriteti kompetent vlerësoj pretendimet i parashtruesit të ankesës se procedura gjyqësore në lëndën ku i njëjti ka cilësinë e palës, është zgjatur nga viti 2019 kur është parashtruar padia deri në vitin 2023, se janë ndërruar disa gjyqtarë dhe seanca gjyqësore përfundojnë vetëm me konstatimet se kush merr pjesë në seancë e kush jo dhe gjeti se për arsyet e shtyrjes së seancave dhe ndërrimit të disa gjyqtarëve, parashtruesi i ankesës është njoftuar detajisht nga Gjyqtari Mbikëqyrës i Degës në I. dhe të njëjtat nuk janë shkelje të natyrës disiplinore përkatësisht, këtu parashtruesi i ankesës me asnjë provë nuk e ka argumentuar se me cilat veprime, gjyqtarët ndaj të cilëve ka parashtruar ankesë kanë kryer shkelje të natyrës disiplinore Andaj, meqenëse ankesa disiplinore është e paargumentuar dhe përbëhet vetëm nga pretendime që nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore, autoriteti kompetent gjeti se ankesa disiplinore duhet të refuzohet si e pabazuar.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - AD/GJTHPE/.nr.7/23, me datë 18.08.2023.**

**Kryetari i Gjykatës  
Armend Berisha**

**Vendimi i dorëzohet:**

1. *Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
2. *Gjyqtarit SH.H*
3. *Gjyqtarit M.K*
4. *Gjyqtarës P.B*
5. *Parashtruesit të ankesës – S.K*